

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ARKIVIN SHETETËROR VENDOR VLORË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Arkivin Shtetëror Vendor Vlorë, institucion i vartësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit të Shtetit Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit”, për periudhën nga inspektimi i fundit deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 51, datë 27/05/2014..

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresat nr. 175/9 dhe nr. 175/10, datë 27/05/2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Gjet Ndoj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit të Shtetit Tiranë dhe z. Auron Rrokaj, me detyrë Drejtor i ASHV Vlorë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi në ASHV Vlorë rezultoi se pranë kësaj njësie është arkivuar pasuria dokumentare e institucioneve të cilët më parë kanë zhvilluar aktivitetin e tyre brenda njësisë administrative të Qarkut Vlorë. Sasia e përgjithshme e dokumentacionit që ndodhet e arkivuar pranë ASHV Vlorë është 563,02 ml. Nga kjo sasi 337,05 ml (metër linear) është dokumentacion i përpunuar. Vetëm një pjesë e vogël e kësaj sasive të përpunuar është e pajisur me mjetet e informacion (inventarët). Sasia tjetër prej 225,97 ml është dokumentacioni ende i papërpunuar.

U konstatua se për shkak të mungesës së inventarëve për pjesën e përpunuar të fondeve ka vështirësi në shfrytëzimin e tyre, vonesa në plotësimin e kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve të cilët kërkojnë shërbim për pajisje me dokumentacion.

Nga auditimi rezultoi gjithashtu se institucionet shtetërore që në përputhje me dispozitat e ligjit të sipërcituar kanë detyrimin të dorëzojnë dokumentacionin pranë ASHV Vlorë në veprim me autoritetin fond krijues, nuk kanë kryer procedurat për dorëzim. Nga ana tjetër edhe vetë ASHV Vlorë nuk ka nisur procedurat për kërkim dhe tërheqje të dokumentacionit që sipas ligjit për arkivat ka për detyrë të ruajë në fondin e vet arkivor.

Nga auditimi rezultoi se ambientet e ASHV Vlorë nuk respektojnë as normat minimale për një ruajtje të përshtatshme të dokumentacionit. Arsye kjo që e ka sjellë edhe mangësinë e cituar në paragrafin e mëparshëm. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

a. DPA Tiranë në bashkëpunim me ASHV Vlorë të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e dokumentacionit të përpunuar me inventarë, evidentimin e inventarëve brenda fondeve, ribërjen e inventarëve në rastin e evidentimit të mungesave.

Brenda vitit 2014

b. DPA Tiranë të marrë masat e duhura për krijimin e kushteve normale të punës në ASHV Vlorë, në mënyrë që kjo ASHV të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

Brenda vitit 2014

2. Auditimi konstatoi se ASHV Vlorë në kundërshtim me dispozitat e ligjit për arkivat nuk ka regjistruar pasurinë dokumentare jo administrative që ekziston në njësinë administrative të saj. Si rrjedhojë nuk është në gjendje të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave

(DPA Tiranë) për sasinë totale të pasurisë dokumentare jo administrative. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

ASHV Vlorë në bashkëpunim me DPA Tiranë të marrë masa të menjëhershme për fillimin e regjistrimit të pasurisë dokumentare administrative dhe jo administrative në njësinë administrative që mbulon ASHV.

Menjëherë

3. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në urdhrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr.1, datë 15.01.2004 “Për transferim të përkohshëm dokumentesh”, për qëllim ruajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumentacionit është transferuar një sasi dokumentacioni nga ASHV Vlorë në vend ruajtjen e ASHV Lushnjë. Ky transferim është kryer në periudhën e transferimit të ASHV Vlorë nga një godinë (ish tunelet e ushtrisë) në një godinë tjetër. Nga verifikimet u konstatua se mungon Urdhri nr. 1, datë 15.01.2004 i sipërcituar, por janë mbajtur procesverbalet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit. Nga auditimi i procesverbaleve të dorëzimit të ASHV Lushnjë nr. prot. 534 datë 12.09.2007 u konstatua se pranë ASHV Vlorë është dorëzuar përsëri dokumentacionit prej 1020 kuti i ardhur dhe ruajtur përkohësisht në ASHV Lushnjë i pajisur dhe me procesverbalet përkatëse. Për shkak të lëvizjeve të dokumentacionit arkivor që ruan kjo ASHV nga një vend ruajtje në një tjetër, kryer me persona dhe mjete të papërshtatshme, ka përzierje të dokumentacionit, humbje të inventarëve, si dhe humbje të dosjeve. Mangësitë e dosjeve të ndryshme në fonde të ndryshme janë evidentuar dhe pasqyruar nga punonjësit gjatë punës së tyre në vite. Një pjesë tjetër e dokumentacionit në ruajtje në ASHV Vlorë, kryesisht me karakter pronor, është transferuar përkohësisht për qëllime certifikimi në DPA Tiranë. Këto fonde janë rikthyer të certifikuara nga DPA Tiranë në ASHV Vlorë të shoqëruara me procesverbalin përkatës, datë 10.10.2006.

Rezultoi gjithashtu se në përputhje me Urdhrin e DPA Tiranë nr 4 dt. 10.02.2005, i bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 13.12.2001 “Për riorganizimin e rrjetit arkivor vendor” pika 3, si dhe në Urdhrin nr. 6 datë 12.07.2004 të Këshillit të Ministrave, pranë ASHV Vlorë ruhet edhe fondi arkivor i ish ASHV Sarandë. Fondi arkivor i ish ASHV Sarandë është dorëzuar me procesverbal nr. prot. 86/1, datë 15.02.2005 mbajtur midis ASHV Sarandë si dorëzues dhe ASHV Vlore si marrës në dorëzim. Sasia e përgjithshme e dokumentacionit e cila administrohej nga ASHV Sarandë është dorëzuar në ASHV Vlorë dhe është gjithsej 249 ml.

Për sa i përket lëvizjes dhe qarkullimit të dokumentacionit nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me dispozitat e ligjit për arkivat nuk ekziston asnjë regjistër i lëvizjes së dokumentacionit ku të jenë regjistruar zhvendosjet e detyruara të dokumentacionit në ruajtje pranë ASHV Vlorë. Pavarësisht faktit që janë mbajtur procesverbale të rregullta të lëvizjeve që ka pësuar dokumentacioni në ruajtje pranë ASHV Vlorë, nuk rezulton të jetë përmbushur detyrimi ligjor i regjistrimit të këtyre lëvizjeve në një regjistër të posaçëm. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

ASHV Vlorë, në mënyrë të menjëhershme, të krijojë një regjistër të posaçëm për lëvizjet e dokumentacionit në të cilin të regjistrojë lëvizjet që ka pësuar dokumentacioni në ruajtje, në përputhje me procesverbalet ekzistuese përkatëse.

Menjëherë

4. Nga auditimi rezultoi se selia e ASHV Vlorë është vendosur në katin e parë të një ndërtese që ka qenë në pronësi të “Ish Komandës së Kohës së Veçantë” të Qytetit Vlorë. Më parë selia e ASHV ka qenë në tunelin poshtë kodrës së Kuzumbabait, në pronësi të Shtypshkronjës

“Flamuri”. Sallat e ASHV Vlorë, ku është depozituar dokumentacioni në ruajtje janë jashtë çfarë do lloj kriteri teknik në lidhje me kushtet e ruajtjes të vendosura me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”. Sallat e ruajtjes së dokumentacionit të ASHV Vlorë janë të pajisura me rafte të cilët kanë deri në 11 nivele, plot me kuti dokumentash dhe që nuk respektojnë distancat e vendosura me ligj nga dyshemeja, tavani apo distancat anësore në mënyrë që të lejojnë një ajrosje të përshtatshme të dokumentacionit. Rezulton që hapësirat nuk janë të mjaftueshme për të krijuar lëvizje ajri, i nevojshëm në një ambient ku nivelet e lagështirës janë tepër të larta. Po ashtu muret dhe tavanet janë plot myk e lagështi dhe godina ka një pozicion të tillë (jug – perëndim) e rrethuar nga masa dhe që nuk lejojnë depërtimin e një ndriçimi natyral të mjaftueshëm. Nivelet e temperaturave dhe të lagështisë rezultojnë po ashtu jashtë normave të parashikuara me ligj. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

DPA Tiranë të marrë masa të menjëhershme për zhvendosjen e ASHV Vlorë në një mjedis të përshtatshëm, në përputhje me normat tekniko – profesionale për ruajtjen e dokumentacionit.

Menjëherë

5. U konstatua moszbatimi i Urdhrit të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 88, datë 11.12.2007. “Për vënien e sqarimeve plotësuese në shkresën përcjellëse të dokumenteve arkivore që i jepen publikut”, nëpërmjet të cilit urdhërohen të gjitha ASHV, që në raste falsifikimi dokumentacioni të vërtetuar me vendime gjyqate, të merren masa për heqjen nga përdorimi të tyre për publikun, dhe ruajtjen e tyre të veçuar dhe të evidentuar. Urdhërohet njoftimi i DPA për të marrë masat e nevojshme.

Gjatë auditimit u konstatua: Prokuroria e Rrethit Vlorë i ka dërguar ASHV Vlorë për dijeni dhe për marrjen e masave përkatëse Vendimin për pushimin e çështjes penale nr. 121 të vitit 2008, nr prot 779/1, datë 31.05.2008. Në këtë vendim Prokuroria e Rrethit Vlorë vendos - duke iu referuar një Vendimi të Gjykatës së Rrethit Vlorë (çështje civile) në lidhje me Aktin e Ekspertimit Grafik Nënshkrimesh dhe Teknik Vulash nr 09/07, datë 27.11.2007, në të cilin evidentohet falsifikimi i Vendimit dhe Projekt Vendimit nr. 41, datë 16.08.1991 i Komitetit e Ekzekutiv Pluralist të Rrethit Vlorë të vitit 1991 – për mos procedimin me ngritjen e çështjes penale kundër z. Edmond Fetahu, pasi nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar që personi në fjalë ka kryer veprën penale të falsifikimit, të parashikuar nga nenin 187 i kodit penal.

Sipas Aktin të Ekspertimit Grafik Nënshkrimesh dhe Teknik Vulash nr 09/07, datë 27.11.2007, në të cilin evidentohet falsifikimi i Vendimit dhe Projekt Vendimit nr. 41, datë 16.08.1991 i Komitetit e Ekzekutiv Pluralist të Rrethit Vlorë të vitit 1991, me referenca arkivore Fondi i Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Rrethit Vlorë Viti 1991, numër dosje 4, i cili ka dalë dhe është shërbyer si i certifikuar me numër certifikimi fleta 1 – 36537, fleta 2 – 36538, firma e titullarit të Komitetit Ekzekutiv KP të qytetit Vlorë, shtetasit Petref Lameborshi dhe vula në të njomë e institucionit janë të falsifikuara. Si rrjedhim dokumenti në fjalë rezulton, sipas ekspertizës dokument i falsifikuar.

Në ASHV Vlorë pas njoftimit nga organi hetimor nuk janë marrë masat e cituara në Urdhrin nr. 88 për mënjanimin e dokumentacionit, i cili rezulton i falsifikuar. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

ASHV Vlorë të verifikojë nëse ka raste të tjera në analogji të gjetjes së grupit të auditimit dhe të respektojë me korrektesë Urdhrin nr. 88 e DPA Tiranë, datë 11.12.2007, “Për vënien e sqarimeve plotësuese në shkresën përcjellëse të dokumenteve arkivore që i jepen publikut”, në të gjitha rastet e falsifikimit të dokumentacionit të vërtetuar me vendim gjyqate.

Menjëherë

6. Grupi i auditimit të KLSH pas konstatimit të korrespondencës mes ASHV Vlorë dhe Prokurorisë së Rrethit Vlorë vazhdoi auditimin e procesit të certifikimit të këtij dokumenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Tiranë ku konstatoi se dokumenti i certifikuar është i njëjtë me mikrofilmimin. U konstatua gjithashtu se fletët 1 dhe 2 të Vendimit nr. 41, datë 16.08.1991, të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit Vlorë “Për dhënie leje banimi qytetarëve”, i cilësuar si i falsifikuar nga akti i ekspertizës, kanë të njëjtin numër certifikimi – 36357 dhe 36358 – me fletët 1 dhe 2 të Vendimit nr. 40/1, datë 16.08.1991, të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit Vlorë “Për Shitblerjen e Banesave”. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

DPA Tiranë të krijojë një grup pune për të verifikuar procesin e certifikimit të dokumenteve me karakter pronor të cilat janë në ruajtje dhe shërbejnë pranë ASHV Vlorë dhe njësive të tjera vendore ku rezultojnë problematika të ngjashme.

Menjëherë

7. Nga auditimi rezultoi se në ASHV Vlorë nuk ka gjurmë akt kontrollesh të lëna nga Drejtoria e Inspektimit – Kontrollit përmes inspektorëve të saj ku të parashikohen masa dhe detyra në ngarkim të punonjësve të ASHV Vlorë si në lidhje me metodologjinë tekniko – profesionale të ruajtjes së dokumenteve, si në lidhje me ruajtjen fizike të dokumenteve dhe me sigurimin e ndërtesave të ASHV Vlorë, në kundërshtim me kërkesat e Kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 04.03.2004 për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, nenet 10, 11 e 12, ku përcaktohet se: “....cakton detyra me shkrim dhe **lë akt kontrolle për mangësitë e vërejtura në punën arkivore dhe kontrollon zbatimin e tyre**”, trajtuar në Projektraportin e Auditimit. Për më tepër (për periudhën e auditimit) midis Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimeve pranë DPA-së dhe ASHV Vlorë komunikimi nuk ishte i dokumentuar me shkresa zyrtare, por vetëm me komunikim verbal. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

a. Drejtoria e Inspektimit – Kontrollit në DPA Tiranë të marrë masat e duhura për kryerjen e inspektimeve dhe dokumentimin e tyre në përputhje me kërkesat e neneve 10, 11 e 12, të Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.

Menjëherë

b. DPA Tiranë të analizojë punën e kryer nga Drejtoria e Inspektimit – Kontrollit dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos përmbushjen e detyrave të përcaktuara në ligjin për arkivat dhe në rregulloren e brendshme të DPA-së.

Menjëherë

8. Nga auditimi në ASHV Vlorë, lidhur me grumbullimin e të ardhurave, kanë rezultuar praktika të pambështetura në bazën ligjore, si pagesat për shërbimet ndaj qytetarëve me fatura dhe jo nëpërmjet bankës, kryerja e shërbimeve për dhënie dokumente nga arkivi, pa paraqitur dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse nga banka, etj. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

ASHV Vlorë për çdo shërbim për dhënie të dokumentacionit të arkivit subjekteve private dhe shtetërore, të veprojë vetëm pasi të paraqitet nga subjekti dokumenti i pagesës nëpërmjet bankës.

Menjëherë

9. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me truallin e ndërtimit, prone e ASHV Vlorë, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, nuk ka ndjekur procedurat për krijimin e kushteve për ndërtimin e zyrave të reja të ASHV Vlorë. Për një pjesë të truallit, rreth 200 m² është tjetërsuar pronësia nga shteti tek privati. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit Tiranë, të bëjë hipotekimin e pronave të ASHV Vlorë dhe të ndjekë në rrugë ligjore (gjyqësore), çështjen për pjesën e truallit që është tjetërsuar nga pronë e shtetit në pronë private.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa “ç”, dhe 59 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i kërkojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Tiranë, të ndjekë zbatimin e procedurave sipas pikave 2, 3 të kreut II të VKM nr. 115, datë 15.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” për dhënien e masës disiplinore:

“Largimin nga Shërbimi civil”, për:

1. Znj. ■■■, ish Drejtoreshë e Arkivit Shtetëror Vendor Vlorë, pasi
 - ka lejuar lënien në qarkullim të dokumenteve që Prokuroria e Gjykata e rrethit Vlorë i kanë klasifikuar të falsifikuar, duke mos zbatuar kërkesat e ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
 - ka krijuar mundësi abuzimi e përfitimi të padrejtë nga persona që e kanë marrë shërbimin e këtij dokumentacioni.
 - ka lejuar me veprimet dhe mos veprimet e saj krijimin e gjendjes së përshkruar lidhur me mënyrën e evidentimit të dokumentacionit që është arkivuar në institucionin që ajo drejtonte.

C. KALLZIM PENAL

1. Znj. ■■■, ish Drejtoreshë e Arkivit Shtetëror Vendor Vlorë, pasi ka lejuar lënien në qarkullim të dokumenteve që Prokuroria e Gjykata e rrethit Vlorë i ka klasifikuar të falsifikuar, duke mos zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe ka krijuar mundësi abuzimi e përfitimi të padrejtë nga persona që e kanë marrë shërbimin e këtij dokumentacioni.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT